SIÇ MË THOTË NËNUA PLAKË *

MUSINE KOKALARI **

Lermë biro[1], mos më mer mënden, mos më rokanis[2], mos më shkul zorët. E ç'të lipsen[3] se si rronim ne? Pse, apo të qeç, se ç'u bëmë ne, nuk jua kemi zënë sinë, apo mos ju prishmë hundën?

Oh, kohë, kohë e shkretë, se si u kthie kjo botë përmbis. S'merr vesh i pari të ditin, nuk njihet i madhi nga i vogli, u bënë të gjithë si këmbët e dhisë? Ç'na panë e ç'panë sitë, që më mirë të ishim verbuar e shurdhuar, se sa arritmë këtë ditë.

U prishnë të gjitha nikoqirllëqet e para. Femërat e zeza në ditën e sotme u bënë një be, duallnë malë çardhakut[4], e kanë mënden malë fikut. U thafçin

[1] *biro – këtu:* bijë
[2] *rokanis* – grind
[3] *ç'të lipsen* – ç'të duhet
[4] *çardhak* – vend i ngritur

e mos u bëfçin më mirë… të mos u skuqet fare faqja kështu, të mos mblidhen çikë[5] në shtëpi, mbetën udhëve dhe s'i sheh kurrë me një zanat në dorë.

Ike vajzë se s'të shoh dot përpara, më ngjethet mishtë kur më del me kërcinj hapur, me llërë[6] zbuluar. U rrite, u bëre sa një lopë, nuk ma sheh shtatin sa ma ke, të vate koka në tavan… u bëre për në shtëpin' e botës dhe akoma s'ke vënë mënt. Lipsmu[7] këtej, do dhe të të thom se si ishin në kohët tona. Mos më mbush barkun me vrer[8], dhe kjo që na gjeti nuk e prisnja.

Gjithë ditën e ditës se ç'bën, s'marr vesh, shkruan, këndon, bën xivo-gavo[9], zë miza e kren[10] sitë. S'di, më thonë se do bëneç mësonjëse. U! pika ne kokë, gjithënjë njësoj, në diell[11]. Dëgjomë mua, unë në kohën tënde kisha di djelm dhe babain tënd tre, dhe ti akoma nuk di se ç'do me thënë gjëlpërë, si mbahet fshesa, s'ke ngritur kurrë një qime nga dheu.

He, he, ç'zakone që kishim, si dëgjohej fjala e të madhit, si dridheshim, po të paktën kishte hije. Eja biro në vehte, shtroju punës, hir në udhë të Perëndisë, se nga këndimet nuk nxjerr gjë. Nis nga qëndizma, nga pala se s'ke bërë gjë, duart e zeza i ke të thara. Pika burrit që do të marrë, lumi shtëpisë që do të të presë, mos ke ndërmënt të bëç dhe atje kështu… u… më mirë të të përpijë dheu të gjallë, se sa t'na turpëroç.

Më qajnë sitë, vajzë të keqen sa të shoh dhe ti nuse, se jam plakë dhe kush e di ç'më ngjan. E pse më vështron[12] ashtu, apo ke në mënde ta marrëç vetë si vajza e Halil Efendiut. Ngreje nga mëndja, kaqë ta bëç dhëmbin, të hidhesh në tra. Sa ke babanë gjallë, s'i del dot njeri përpara, se të merr shpirtin, të shkurton nga kembët. Të beç si ka urdhëruar Zoti.

---

[5] *çikë* – pak
[6] *llërë* – pjesa e krahut mbi bërryl
[7] *lipsmu* – ik këtej
[8] *vrer* – helm
[9] *xivo-gavo* – të shkruara të kota
[10] *krej* – nxjerr
[11] *në diell – këtu:* njeri i pa menduar
[12] *vështroj* – shikoj

Thuaj si të duaç, nuk i shoh dot vajzat e sotme. U tërbuan fare, duan burrë, nuk u rrihet, gjithënjë mënden atje e kanë. Iu ka plasur cipa. Ç'janë ato të hira e të dala, fërc tek njera, fërc tek tjetra, ato të qeshura, ato të kukurisura[13]… Pse më dridhen ashtu, ç'janë ato rroba që më bëjnë pas trupit, sikur do t'u çahen veshur. Ç'janë ato nisëla[14], ata të kuq e të bardhë që më vënë, po për nusëri ç'do të lënë. Janë të udhës këto, ku është parë kështu? Pa u martuar flasin me burra, më dalin krah më krah, sa i sheh gjithë bota. Jo, jo, kjo është e tepërtë. Ne na zinte babai, as na pjete fare dhe nuk e shihnim gjer sa martoneshim. Dhe atje që venim na dridheshin këmbët. Bulla[15] që na qëndronte në krah na shponte me dorë, rri kështu, rri ashtu, ul kokën, ngre supet, zeju dorën[16]. Ta ka 'nda, dukej q'ishim nuse. Të thom, u bëra kaqë, nuk di se si është te thënit e emrit të burrit. U bëra me gjashtë fëmilë, nuk thaçë di fjalë radha me të ndjerin: na, nama[17], merre, jepe, atë, këtë, këto qenë fjalët tona.

Vajzat e sotme, me t'u martuar jo më dhëmb brinja, jo këmba, jo koka. Gjithë ditën e ditës shtrirë, trash' e gjërë, nuk zënë punë me dorë, nuk vrasin mënden fare, flakën shtëpisë, s'ngrënë qimen nga qulli dhe vjehrat bëhen të liga. Kanë të drejtë të flasin dhe ato, lihet shtëpia në ditën e kujos[18]?!

Mbarsen[19], s'tunden nga vëndi, se mos e shtien[20], këto zonjë-mëdha. Po ne si s'na gjente gjë, ngrinim o të keqen nga njëra anë në tjetrën, thesin me kallamboq[21] në kraha, nga avlija[22] e në haur[23]. Pikë! S'pësonim gjë, as dorë, as këmbë thienim dhe kurrë nuk sëmureshim, shtëpise i vinim rreth me një grikë fëmilë, që na mirrnin këmbët. Thuajmë si të duken këto, po ç'të bëni,

---

[13] *të kukurisura* – të qeshura me zë të lartë
[14] *nisëlë* – stoli, të zbukuruar
[15] *bullë* – gruaja që nis nusen gjatë javës së martesës dhe e shoqëron dhe në shtëpinë e burrit
[16] *zeju dorën* – puthju dorën
[17] *nama* – ma jep
[18] *dita e kujos* – dita më të keqe
[19] *mbarsem* – bie shtatzënë
[20] *shtie* – avortoj lindjen
[21] *kallamboq* – misër
[22] *avli* - oborr
[23] *haur* – dhomë e shkëputur në oborr

ju tërboi shkolla biro! dëgjon, dëgjove? Ua hoqi dhe atë çikë mënde që kishit, ua bëri fiu. Mallëkuar qoftë kush e hapi për herë të parë, na prishi shtëpinë, se lipsur të jetë dhe ai mësim.

Nuk e di se si u bëmë kështu. Njeri s'na shikon, njeri s'na vë veshin, njeri s'na përfill, shkojnë dhe as kokën s'na kthejnë. U duket se arritnë qiellin me dorë, u duket sikur jemi lecka. Po falin e kanë dhe burrat qe ju lanë juve mbi kokë. Ata u bënë gra dhe ju u bëtë burra. Eh! ku vate tëllësëmi[24] i parë që këmbë dëgjonim jashtë, rrëzave futeshim.

Ju daltë zverku[25], ju plastë dell' i ballit[26], që s'na latë të vdisnim siç duhesh. Mbemë për gjëmë[27] sikur na kish nëmur[28] njeri, që rrofç e mos gëzofç. Për Perëndi balta mjaltë, po kështu s'na latë radhë, kur qaf' e kur kungull.

Nuk të shoh dot përpara, ikmë ketej, se m'u bënë sitë miza-miza. Ikmë të keqen e mos më bjer në qafë se s'të kam ngenë. Nuk të hin në punë se si rronim, ju shihni t'uajat. Mënjanmu këtej, se kur më del përpara kështu, nuk dua të të shoh për njëqint vjet.

---

[24] *tëllësëm* – tërsëllim, të bërtitur
[25] *zverk* – qafë
[26] *të plastë dell' i ballit – këtu:* njeri i paturpshëm
[27] *gjëmë* – fatkeqësi
[28] *nëm* – mallkoj

* *"Siç më thotë nënua plakë"* është një tregim i shkëputur nga vepra me të njëjtin emër, botuar në vitin 1940. Ky libër konsiderohet si një nga librat e parë të shkruar nga një grua shqiptare. Në këtë tregim, autorja pasqyron jetën dhe marrëdhëniet shoqërore të grave, përmes një nëne të moshuar që krahason zakonet e dikurshme me ato të brezit të ri.

** *Musine Kokalari* (1917-1983) renditet si një nga shkrimtaret e para shqiptare. Përmes shkrimeve të saj, ajo u angazhua për emancipimin e gruas dhe për vendin e saj në shoqërinë tradicionale, duke i dhënë zë gruas në letërsinë shqiptare. Ajo ka qenë themeluesja e partisë socialdemokrate dhe mbështetëse e hapur e demokracisë dhe pluralizmit në Shqipëri. Për qëndrimet e saj u dënua nga regjimi komunist në vitin 1946. Kaloi rreth 18 vjet në burg, pastaj u internua në kampet e punës së detyruar të diktaturës komuniste, ku iu ndalua të shkruante. Vdiq në izolim nga kanceri i gjirit në vitin 1983, pasi iu refuzua trajtimi mjeksor.